

19-09-2018

AKTI I THEMELIMIT TË SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "RECONSTRUCTING MEMORIES" SH.P.K.

KREU 1

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

NENI 1

Neritan Zinxhiria, i biri i Shpëtim-it, lindur më 28.04.1989 në Tiranë, banues në Kodrigktonos 34 Str, Victoria Sq., 11251, Athinë, Greqi, pajisur me pasaportën BA0722826

Si themelues të kësaj Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar, vendosi të hartojë këtë Akt Themelimi, mbështetur në parimet e mëposhtme:

NENI 2

EMRI

Emri i shoqërisë është "RECONSTRUCTING MEMORIES" sh.p.k.

NENI 3

FORMA

Shoqëria do të ketë statusin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe ortaku do të përballojë humbjet deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nëshkruara për kapitalin.

NENI 4

SELIA

Shoqëria e ka selinë e saj në Tiranë, në Rr. Ismail Qemali, Pallati 2k., Apt.44 , Njësia Bashkiake nr. 5.

Selia e shoqërisë mund të ndryshohet nëpërmjet vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 5

AFATI

Shoqëria do të ketë kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj me një afat të pacaktuar.



NENI 6

OBJEKTI

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është:

Prodhim filmash; prodhime audio-vizive; realizime evente të ndryshme artistike, fushata publicitare; realizime grafike, website, trajnime, punëtori, etj. Dhe kryerja e çdo aktiviteti të lejuar nga ligji që lidhet direkt ose indirekt me objektin e veprimtarisë.

NENI 7

KAPITALI

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100,000 (njëqind mijë) lekë. Kuotat e kapitalit themeltar të shoqërisë janë të ndara dhe nënshkruar si mëposhtë:

1. **Z. Neritan Zinxhiria** në cilësinë e ortakut themelues zotëron **100%** të kapitalit themeltar ose 1 kuotë të barabartë me vlerë prej 100,000 (njëqindmijë) lekë në kapitalin themeltar.

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet ose të zvogëlohet sipas vendimeve të Asamblesë së Ortakëve, por asnjherë nuk mund të zvogëlohet nën minimumin ligjor.

NENI 8

ORGANET E SHOQËRISË

Organet drejtuese të shoqërisë janë :

- Asambleja e përgjithshme;
- Administratori.

Fusha e veprimit, përbërja dhe mënyra e funksionimit të organeve drejtuese do të rregullohet sipas ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar dhe Statutin e shoqërisë.

ORGANI ADMINISTRATIV

NENI 9

Administrator i parë i shoqërisë është Z.Neritan Zinxhiria, pajisur me pasaportën me nr. BA0722826.

THEMELUES

Neritan Zinxhiria
